



Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

Nr. 401-30854/09

Klinë, datë: 10.09.2024

## PROCESVERBAL

**Nga dëgjim i dhjetë publik i përgjithshëm buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Klinës, me banorët e komunës së Klinës, datë 25.08.2024, ora 17:00, vendi Salla e Kuvendit Komunal.**

**Ky dëgjim buxhetor i cili ka qenë i planifikuar të mbahet në ora 17:00, sipas njoftimit zyrtar, për shkak të kërkesave të qytetarëve për ndërrim të orarit, takimi është mbajtur në ora 15:00.**

**Komuna e Klinës për herë të parë ka organizuar takim ditën e dielë, të vikendit për të parë dhe krahasuar mundësit për pjesëmarrje më e lartë, orar më fleksibilitet dhe një mundësi më e mirë për të përfshirë një spektër më të gjerë të komunitetit, përfshirë prindërit, studentët dhe individët që kanë angazhime të tjera gjatë javës.**

**Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.**

**Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 15/09/2024 në emalin [vlor.tafilir@rks-gov.net](mailto:vlor.tafilir@rks-gov.net) ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.**

**Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.**

**Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.**

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen na takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i draft buxhetit i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike. Para të pranishmëve është prezantuar draft buxheti edhe në formatin elektronik në tabelat e mençura. Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 15:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtori i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Agron Bacaj, drejtori i Inspektoratit, Faruk Smajli, anëtarë të grupit punues si dhe qytetarët pjesëmarrës.

**Nga qytetarët morën pjesë 27 persona, prej të cilëve 1 grua dhe 28 burra.**

*Shtojca 1 – Fotografi nga dëgjim i dhjetë publik i përgjithshëm buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Klinës, me banorët e komunës së Klinës, vendi Salla e Kuvendit Komunal.*



**Takimi u hap nga moderatori, Mirsad Dakaj, i cili hapi takimin:**

“Përshëndetje të nderuar të pranishëm!

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin për Financa Publike dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, sot ne po hapim ciklin e dëgjimeve buxhetore për draft buxhetin e komunës së Klinës për vitin 2025, i cili është një proces shumë i rëndësishëm dhe thelbësor për t'i përcaktuar prioritetet e komunës për vitin e ardhshëm, për t'i pranuar kërkesat e juaja e të cilat grupi punues për draft buxhet do t'i shqyrtojë dhe analizojë me kujdes.

Në këtë takim jemi këtu bashkë me kryetarin e komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtori i Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berisha, drejtori i Urbanizmit, Enver Berisha, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Agron Bacaj, drejtori i Inspektoratit, Faruk Smajli dhe anëtarë të grupit punues.

Dua të theksoj se komuna e Klinës është vlerësuar nga organizata joqeveritare, si DEMOS-i, e institucione të tjera, si komuna që ka pasur raportin më të mirë në Republikën e Kosovës të cikleve të dëgjimeve buxhetore në vitet e fundit për respektimin në përpikëri të dispozitat ligjore dhe është shembull për komunat e tjera. Me insistim të kryetarit jemi duke u angazhua që rezultatin e mirë që e kemi pasur vitin e kaluar me vazhdu edhe këtë vit dhe me krijua një praktikë të punës transparente dhe llogaridhënëse.

Duke e pasur për bazë këtë, ne si grup punues nuk kemi ndryshu shumë metodën e punës nga viti i kaluar. Në koordinim me kryetarin kemi hartua planin e punës, sikurse vitin e kaluar, ne kemi planifikuar t'i mbajmë 10 dëgjime buxhetore në lokalitete të ndryshme dhe po ashtu jemi të hapur t'i pranojmë kërkesat e sugjerimet edhe në formë elektronike deri me datën 30 gusht, ndërsa në fund, duke i respektuar edhe kornizën ligjore, draft-buxheti do të miratohet në kuvendin e komunës.

Para se me ia kalu fjalën kryetarit, kisha kërku nga ju që me u nënshkru në listën e pjesëmarrësve, sepse është një nga obligimet që dalin nga Udhëzimi Administrativ për Administratë të Hapur.

Po ashtu edhe për kërkesat e miratuara të qytetarëve, ku këtë vit vetëm në KAB janë të miratuara rreth 90% të kërkesave e synojmë që e njëjta përqindje të jetë edhe në Draft-Buxhet.

Megjithëse ne kemi planifikuar t'i mbajmë takimet në disa lokalitete, kërkesat nuk duhet të kufizohen.

**Të pranishmit u njoftuan nga moderatori se për qëllime të dokumentimit të këtij takimi do hartohet procesverbali dhe komuna do publikoj video dhe fotografi nga ky takim.**

Të gjithë të pranishmit dhanë pajtimin për regjistrimin e takimit dhe publikimin e imazheve nga ky takim.



*Pas përfundimit të fjalimit të moderatorit fjala ju dha kryetarit të komunës.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Të nderuar pjesëmarrës, është kënaqësi për mua që sot, ditë e dielë, të jemi bashkë këtu dhe të diskutojmë për buxhetin e vitit të ardhshëm të komunës sonë. Ti diskutojmë prioritetet tona të përbashkëta për zhvillimin ekonomik, infrastrukturën, dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Qëllimi ynë është që ky buxhet të reflektojë sa më mirë nevojat e çdo qytetari, duke përfshirë propozimet dhe sugjerimet tuaja që janë të rëndësishme.

Buxheti i këtij viti është hartuar me kujdes të veçantë për të siguruar që resurset tona të shfrytëzohen në mënyrën më të mirë të mundshme, duke pasur parasysh situatën financiare dhe mundësitë për të tërhequr fonde shtesë nga donatorë të jashtëm. Prandaj, ky dëgjim buxhetor është një mundësi për të përfshirë kërkesat tuaj dhe për të siguruar një plan të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës që i shërben interesit të përbashkët.

Unë më shumë do ndalem tek projektet dhe investimet që si komunë i kemi në faza fillestare e pastaj drejtori i Financave do na flas më shumë për buxhetin si dokument financiar dhe çfarë përmban ai.

Disa nga projektet më të rëndësishme që janë duke u ekzekutuar e që janë fundërruesi për furnizim me ujë të pijes, në vlerë afër një milion euro, që bashkë me njësinë e “Hidrodrini-it”, po shpresojmë që brenda këtij viti të kemi furnizim me ujë të pijes 24 orë. Punimet deri me tani kanë shkuar sipas planit dinamik të paraparë i cili do të përfundojë brenda këtij viti dhe këto punime do të rrisin kapacitetin e fabrikës së ujit e cila do të mbulojë gjithë pjesën e qytetit me lagje. Projekt tjetër i cili do të përfundojë po ashtu sivjet kemi edhe rregullimin e shtratit të lumit “Klina”, me infrastrukturë përcjellëse për këmbësor por, ka ndriçim modern dhe pushimore, i cili kap vlerën rreth 750 mijë euro.

Drejt përfundimit jemi më projektin e rregullimi i liqenit akumulues për ujin e pijes, ku ky liqen ka argjinaturë të rregulluar në të dyja anët, ndërsa njëra anë ka infrastrukturë rekreative.

Ndërsa, jemi në fazën fillestare të projektit, ndërtimi shtegut nga qendra e qytetit, sheshi “Ndue Përlleshi”, deri tek udhëkryqi Pejë-Prishtinë, i cili ka po ashtu infrastrukturë përcjellëse për këmbësor dhe biçikletat, ka ndriçim modern, pushimore dhe gjelbërim.

Më rendësi të veçantë jemi duke përfunduar brenda këtij viti edhe ndërtimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të zeza në fshatin Gllarevë, projekt rreth 250 mijë euro. Besojë që edhe vitin e ardhshëm do të jemi të fokusuar në ndërtimin e projekteve të ngjashëm në mënyrë që të ju japim zgjidhjen e duhur trajtimit të ujërave të zeza.

Edhe shtëpia për kujdesin e të moshuarve është në ndërtim e sipër, projekt dy vjeçar në vlerë 540 mijë euro.

Një informacione i mirë për qytetin është edhe ndërtimi i transitit i cili kalon nga udhëkryqi Prishtinë – Gjakovë – Pejë e deri të rruga për Zllakuqan, i cili ka një kosto mbi 8 milion euro, në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, që ka me e lehtësua shumë qarkullimin dhe lëvizjen në qytet.

I prezantova këto projekte për të siguruar që takimi të jetë sa më produktiv dhe efikas dhe kjo të mundësoj që diskutimi të shtrohet dhe fokusohet në projektet e reja me prioritet dhe të mos përsëriten kërkesat e qytetarëve. Tani po ja kaloj fjalën drejtorit të Financave për draft-buxheti dhe të ju informojë si qëndrojmë me kodet dhe kategoritë buxhetore.

*Pas përfundimit të fjalimit të kryetarit, fjala ju dha drejtorit të Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, Enver Berishës.*

**Drejtori i Financave, Enver Berisha:** “Faleminderit Kryetar, faleminderit edhe gjithë juve të pranishmëve që jeni këtu sot në këtë dëgjim buxhetor, veçanërisht në këtë ditë vikendi, po jemi munduar si institucione që pak a shumë të ju ikim angazhimeve të cilat i kemi gjithsecili gjatë ditëve të javës dhe të gjeni kohë më pak obligime. Andaj vlen të vlerësohet pjesëmarrja juaj sot.

Kam kënaqësinë që sot t'ju paraqes buxhetin për vitin e ardhshëm, një dokument që është fryt i analizave të thelluara buxhetore-financiare.

Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2025 është gjithsej, i planifikuar në total prej 16,168,653.00, i cili krahasuar më vitin 2024 është afërsisht 2 milion euro më shumë, i cili ka qenë 14,648,717.00. Nga buxheti i vitit 2025, ajo shumë është e ndarë në këto burime; Granti i përgjithshëm me rreth 6,571,819.00; Granti specifik i arsimit me rreth 5,953,349.00; Granti i shëndetësisë me rreth 1,897,981.00, Të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00; Financimi për shërbimet rezidenciale me rreth 250,000.00, të cilat në japin në total pra 16,168,653.00.

Ndërsa, buxheti i komunës së Klinës sipas kategorive të shpenzimeve për periudhën 2025 – 2027, është i ndarë në të hyrat totale komunale me rreth 16,168,653.00, siç e thamë edhe më herët, të hyrat vetanake me rreth 1,495,504.00 edhe këtë e theksuam me lart po ashtu, Grantet dhe transferet qeveritare me rreth 14,673,149.00, Pagat dhe mëditjet me rreth 8,800,000.00, Subvencionet më rreth 800,000.00, si dhe ajo që po besojë që juve ju intereson më së shumti e që janë Investimet Kapital, kanë një buxhet prej 4,498,653.00. E për projektet kapitale do të bisedojmë bashkërisht. Siç e shihni në dokumentin fizik të buxhetit të cilin e keni përpara, ne si komunë e kemi hartuar një listë të prioriteteve për vitin 2025, po që të cilën mund të ndryshohet apo plotësohet deri ky buxhet të prezantohet në kuvend për tu miratuar.

Unë, nuk duhet të ju lodh më shumë me shifra, jam këtu për çdo pyetje apo kërkesë që e keni për deri tani çfarë prezantova, mbesë në dispozicionin tuaj për përgjigje.

Ju falënderoj edhe njëherë!”

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit drejtor,

Atëherë, qytetarë fjala tani është të ju. Ashtu edhe siç e theksova në fillim, për shkak të procesverbalit ju lutem kur të merrni fjalën të thoni emrin, mbiemrin edhe kërkesa juaj ta ketë adresën e specifikuar, mundësisht. Urdhëroni ?”

*Pas fjalës së Mirsadit, fjala ju dha banorëve pjesëmarrës.*

**Imer Morina, banorë i fshatit Rixhevë:** “Përshëndetje kryetar dhe juve gjithë të pranishëm,

Jam përfaqësues i fshatit Rigjevë. Sot, desha ti shtrojë dy nga kërkesat e banorëve e që janë; **Asfaltim i rrugicave në dy lagje të mbetura në fshatin Rigjevë si dhe ndriçimin publik po ashtu në këto dy lagje.**

Përveç këtyre dy kërkesave, desha të shtroje edhe çështje të tjera e që duam ti dimë; Kemi probleme me emërtim të disa rrugëve të fshatit, desha të di kur do të emërtohen si dhe çështja e Këshillave të Fshatrave, kur do të ndodhë ky proces në bashkësinë tonë lokale? Ju faleminderit!”

*Përgjigjet kryetari i komunës.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Të faleminderit Imer, po përgjigjem të dy çështjeve që i shtrove, ndërsa grupi punues do ti marr shënimet për kërkesa,

E para kërkesat si fshat për emërtimet e rrugëve i dërgoni të komisioni i emërtimit e rrugëve i formuar nga kuvendi komunal ata i shqyrtojnë kërkesat dhe i sjellin në kuvend për miratim.

Ndërsa, ju informojë që komuna e Klinës tashmë ka filluar procesin e konsolidimit të këshillave Lokale, me sukses e kemi organizuar në Ujmirë, Dobërdol, Çabiq, Shtaricë dhe Siqevë e do të vazhdojmë më agjendë edhe në bashkësi të tjera lokale në gjithë Klinën, me sa di janë edhe njëzet të tjera. Po sot jemi këtu për kërkesa edhe buxhetin e vitit 2024.

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit kryetar, vazhdojmë, dikush tjetër a e do fjalën ?

*Fjalën e mori pjesëmarrësi tjetër i paraqitur.*

**Emin Balaj, banorë i fshatit Gllarevë:** “Përshëndetje kryetar dhe juve drejtorë të drejtorive,

Si përfaqësues i fshatit Gllarevë, kemi këto kërkesa për buxhet:

- 1. Shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik modern nëpër lagjet e mbetura,**
- 2. Funkcionalizimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Gllarevë, përkatësisht në lagjen “Balaj”**
- 3. Rregullimin e varrezave të fshatit.**

Ju faleminderit, e njëherësh faleminderit për të gjitha punët që keni arrit me i përfundu në Gllarevë, veçanërisht shkolla tashmë është e rregulluar bukur pasi ka qenë shumë e nevojshme.

**Bardhyl Marmullaku, banorë i fshatit Klinavc:** “Përshëndetje kryetar dhe juve gjithë të pranishëm, së pari desha të ju informoi që në fshatin Dresnik kemi probleme të mëdha me energjinë elektrike dhe që KEDS-i duhet të investojë në tension të lart, do të doja shumë që të bisedoni me përfaqësuesit e tyre dhe të na bëhet një zgjidhje.

Ndërsa për buxhet, si kërkesë e kemi në fshatin **Klinavc, asfaltimin e rrugës “Fadil Boja”.**

*Përgjigjet kryetari i komunës.*

**Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:** “Të faleminderit Bardhyl, çështjen e tensionit të lart të rrymës do ta adresoj të KEDS, pasi që nuk kemi kompetenca të intervenojmë në atë rrejt, po kam marr edhe shumë kërkesa të tilla prej banorëve edhe në takimet e tjera të buxhetit ku ishim të pranishëm nëpër fshatra.

Rruga “Fadil Boja”, do të asfaltohet në kuadër të ndërtimit të transitit të cilën e përmenda më lart i cili nga fshati Dolle do të kaloj jashtë Klinës dikun 200 metra deri të pompa “Baci Petorll”.

*Pas fjalës së kryetaret, fajlen e mori banori tjetër me radhë.*

**Tush Berisha, banorë i fshatit Doberdol:** “Përshëndetje kryetar, ju drejtorë të drejtorive dhe juve gjithë të pranishëm, po prezantohem jam Tush Berisha nga fshati Doberdol, tash më i kthyer nga Diaspor dhe kam vendos të jetojë në vendlindje.

Janë disa çështje që kisha dashtë të i adresoj dhe të shikohen mundësit të jenë pjesë e buxhetit të viti 2025, ashtu si parafolësi këtu, edhe ne kemi probleme me tensionin e rrymës, kërkojë të **rregullohet tensioni i lartë i rrymës në gjatësi dy kilometra nga fshati Ujmirë deri në fshatin Doberdol.** Po ashtu, **rregullimi i rrugës Ujmirë-Gllarevë e që bjen nëpër Doberdol.** Ju faleminderit shumë!

*Fjalën e mori me radhë banori tjetër pjesëmarrës.*

**Tomë Marku, banorë i fshatit Deiq:** “Përshëndetje kryetar dhe juve drejtorë të drejtorive,

Njëherësh ju falënderojmë për të gjitha investimet që janë realizuar në fshatin Deiq, po sot kam një kërkesë për në fshatin Zajm, kërkojë realizimin e **ndriçimit publik modern në rrugën “Qerkin Demaku”**. Ju faleminderit shumë!”

**Mirsad Dakaj:** “Faleminderit z. Tomë ,

A ka dikush tjetër që dëshiron të merr fjalën për ndonjë kërkesë apo rekomandim?”

Nëse jo, atëherë e shpalli të mbyllur takimin pas gjithë këtij diskutimi, ne si grup punues bashkë me kryetarin e komunës dhe rekomandimeve të tije, kemi përpiluar një agjendë jashtëzakonisht të ngjeshur prej dhjetë takime, ky edhe është i fundit.

Ju njoftojë që për dërgimin e kërkesave apo rekomandimeve ka ende afat që ato të përcjellën me shkrim, në kopje fizike apo edhe me email, deri me datën 30 gusht.

Për të gjitha këto takime ju kisha lut ta vizitoni web faqen zyrtare të komunës së Klinës po edhe rrjetin social Facebook për ma shumë detaje apo edhe të kontaktoni me email zyrtaren Vlora Tafili; [vlora.tafili@rks-gov.net](mailto:vlora.tafili@rks-gov.net).

Koment, pyetje, sugjerimet e kërkesa e sotme që janë regjistruar në procesverbal, do të trajton në raportin final të dëgjimeve e më pas ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të kuvendit komunal para miratimit të buxhetit. Po që të cilin do ta gjeni të publikuar në web faqen zyrtare e aty mundeni me i pa secili prej juve që ka kontribuar përgjigjen edhe statusin e kërkesave.

Mirëmbetshi!”.

**Takimi u mbyll në ora 16:29.**

*Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.*

Gra	1
Burra	28
Totali	29

Procesmbajtësja,  
Vlora Tafili